# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6839
E premte, 3 mars 2023
çmimi 0.40


## Ndërron jetë vëllai i Nasim Haradinajt, Agroni FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


KRYEMINISTRI ALBIN KURTI KA RAPORTUAR PARA KUVENDIT PËR TAKIMIN E FUNDIT NË BRUKSEL ME PRESIDENTIN SERB ALEKSANDËR VUÇIQ FAQE 4-5

# PRANIMI I PLANIT EVROPIAN 'PËRPLAS' POZITËN DHE OPOZITËN NË KUVEND



Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka thirrur të enjten seancë parlamentare që kryeministri Albin Kurti të raportojë në lidhje me propozimin evropian për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, në veçanti preambulën e tij. Lumir Abdixhiku, që ishte propozuesi i mocionit për mbajtjen e këtij debati, e kritikoi propozimin evropian për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, në veçanti preambulën e tij. Ndërkaq kryeministri Kurti ka theksuar se fakti që presidenti serb ka refuzuar ta nënshkruajë marrëveshjen bazike në Bruksel, mund të nënkuptojë përgjigjen për pyetjen se kujt i konvenon më shumë kjo marrëveshje

REAGIM I KMDLNJ-së

## GJYKATA SPECIALE VAZHDON SHKELJEN E DREJTAVE TË NJERIUT FAQE 3



## VETINGU NË DREJTËSI, KONJUFCA I DËRGON NË KUSHTETUESE AMENDAMENTET QË LIDHEN ME KËTË PROCES FAQE 5




## OPINION

### VLERËSIMI PËR ADEM DEMAÇIN NGA FOLEJA E QYQES F. 6



Behxhet Sh. Shala - BAJGORA

## AKTUALE



### MINISTRI GREK I TRANSPORTIT JEP DORËHEQJE PAS PËRPLASJES SË TRENAVE F. 2

### KOMPANIA BRITANIKE NJOFTON SE NË DALJE TË PRISHTINËS JANË 640 MIJË TONELATA ARI F. 9

## EKONOMI




### ATK-JA LANSON PROJEKTIN KREDITIMI I TVSH-së F. 8

### VAZHDOJNË HETIMET PËR RASTIN "BREZOVICA" F. 8

## SPORT




### 31 BURSISTË 'SHPRESA OLIMPIKE 2023' DO TË MBËSHTETEN NGA KOK-u F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Ministri grek i Transportit jep dorëheqje pas përplasjes së trenave

LARISË, 2 MARS - Ministri grek i Transportit, Kostas Karamanlis, ka dhënë dorëheqje pasi dy trena u përplasën në veri të Greqisë, prej ku mbetën të vdekur të paktën 43 persona. Ai tha se po largohej nga detyra "në shenjë respekti ndaj njerëzve që vdiqën në mënyrë të padrejtë".
Karamanlis tha se ai kishte bërë "çdo përpjekje" për ta përmirësuar sistemin hekurudhor të Greqisë që, sipas tij, "nuk nuk i përshtatet shekullit 21". "Por, kur ndodh diçka kjo tragjike, është e pamundur të vazhdohet sikur asgjë të mos ketë ndodhur".
Ekipet e shpëtimit kërkuan deri në orët e vona të natës së mërkurë për të mbijetuar mes rrënojave të trenave, në atë që tashmë konsiderohet si përplasja hekurudhore më vdekjeprurëse e vendit.
Kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis e quajti përplasjen e trenit të pasagjerëve dhe një treni mallrash "një aksident të tmerrshëm hekurudhor pa precedent në vendin tonë" dhe u zotua për një hetim të plotë dhe të pavarur.
Ai tha se duket se përplasja ishte "kryesisht për shkak të një gabimi tragjik njerëzor", por nuk dha hollësi.
Autoritetet greke arrestuan drejtuesin e stacionit të trenit në qytetin e Larisës. Ata nuk e publikuan emrin e këtij personi apo arsyen e arrestimit, por drejtuesi i stacionit është përgjegjës për trafikun hekurudhor në atë pjesë të shinave.
Treni me rreth 350 pasagjerë ka qenë duke udhëtuar nga Athina për në qytetin verior të Selanikut. Shumë prej udhëtarëve ishin studentë që ktheheshin nga festimet e karnavaleve.



# Scholz i bën thirrje Kinës të mos i japë armë Rusisë



BERLIN, 2 MARS - Kancelari gjerman Olaf Scholz të enjten i kërkoi Kinës të mos dërgojë armë për ta ndihmuar luftën e Rusisë në Ukrainë teksa i bëri thirrje Pekinit të ushtrojë presion ndaj Moskës për t'i tërhequr forcat e saj.
Nga Parlamenti gjerman, ku foli për vitin e parë të pushtimit rus të Ukrainës, Scholz tha se ishte zhgënjyese që Pekini ishte përmbajtur nga dënimi i pushtimit rus, megjithëse ai përshëndeti përpjekjet e tij për të mos lejuar përshkallëzim bërthamor. "Mesazhi im për Pekinin është i qartë: përdorni ndikimin tuaj në Moskë për ta nxitur tërheqjen e trupave ruse", tha ai. "Dhe, mos i dorëzoni asnjë armë Rusisë agresore".
Vërejtjet e Scholzit nënvizuan se si reagimi ndërkombëtar ndaj luftës në Ukrainë theksoi ndarjet globale, me Kinën dhe Indinë që përmbahen nga dënimi i pushtimit rus.
Shtetet e Bashkuara po shqyrtojnë për mundësinë e vendosjes së sanksioneve të reja ndaj Kinës nëse Pekini ofron mbështetje ushtarake për Rusinë për luftën e saj në Ukrainë, thanë burimet për agjencinë e lajmeve "Reuters" këtë javë.
Konsultimet, të cilat janë ende në një fazë paraprake, synojnë të mbledhin mbështetje nga një sërë vendesh, veçanërisht ato të grupit të G7-s, për ta koordinuar mbështetjen për çdo kufizim të mundshëm. Nga ana e saj, Kina ka nxjerrë një dokument prej 12-pikash që bën thirrje për një armëpushim gjithëpërfshirës që u prit me skepticizëm në Perëndim.

# India u kërkon ministrave të G20-s që të shikojnë përtej krizës Lindje - Perëndim

NJU-DELHI, 2 MARS - Diplomatët e lartë nga 20 vendet kryesore të industrializuara dhe në zhvillim të botës hapën të enjten samitin për bisedimet që priten të jenë të dominuara nga lufta e Rusisë në Ukrainë dhe lëvizjet e Kinës për ta rritur ndikimin e saj global.
India, mikpritëse e këtij samiti, u bëri thirrje të gjithë anëtarëve të G20-s që të arrijnë konsensus për çështjet me shqetësim të thellë për vendet më të varfra, edhe nëse ndarja ideologjike Lindje-Perëndim për Ukrainën nuk mund të zgjidhet.
Në një fjalim me video drejtuar ministrave të Jashtëm të mbledhur në Nju-Delhi, kryeministri indian Narendra Modi u kërkoi atyre të mos lejojnë që tensionet aktuale t'i shkatërrojnë marrëveshjet që mund të arrihen për sigurinë e ushqimit dhe energjisë, ndryshimin e klimës dhe krizën e borxhit. "Ne po takohemi në një kohë ndarjesh të thella globale", i tha Modi grupit, i cili përfshinte Sekretarin amerikan të Shtetit, Antony Blinken, ministrin e Jashtëm kinez Qin Gang, dhe homologun e tyre rus, Sergey Lavrov, diskutimet e të cilëve natyrisht do të "ndikoheshin nga tensionet gjeopolitike". "Ne të gjithë kemi qëndrimet dhe perspektivat tona se si duhet të zgjidhen këto tensione", tha ai, duke shtuar se: "Ne nuk duhet të lejojmë që çështjet që nuk mund t'i zgjidhim së bashku t'i pengojnë ato që mund t'i zgjidhim".
Duke shprehur frikën se përçarja gjithnjë e më e ashpër ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të saj, nga njëra anë, dhe Rusisë dhe Kinës, nga ana tjetër, duket se do të zgjerohet më tej, Modi tha se "multilateralizmi është në krizë sot".
Ai u ankua se dy qëllimet kryesore të rendit ndërkombëtar pas Luftës së Dytë Botërore - parandalimi i konfliktit dhe nxitja e bashkëpunimit - ishin të pakapshme. "Përvoja e dy vjetëve të fundit, kriza financiare, pandemia, terrorizmi dhe luftërat tregojnë qartë se qeverisja globale ka dështuar", tha ai.
Lufta në Ukrainë dhe efektet e saj në energjinë globale dhe sigurinë ushqimore do të dominojnë në shumicën e ngjarjeve ndërkombëtare.




Megjithatë, konflikti i zgjatur ka zgjeruar hendekun mes palëve kundërshtare, duke përkeqësuar një marrëdhënie tashmë të tendosur ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Kinës.
Pavarësisht një propozimi kinez për paqe në Ukrainë, i cili ka marrë reagime pozitive nga Rusia, por reagime negative nga Perëndimi, tensionet mbeten të larta. Ditët e fundit zyrtarët amerikanë e kanë akuzuar Kinën se po mendon ta furnizojë Rusinë me armë.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Ndërron jetë vëllai i Nasim Haradinajt, Agroni

PRISHTINË, 2 MARS - Ka ndërruar jetë Agron Haradinaj, vëllai i Nasim Haradinajt. Agroni ishte luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Pas vdekjes së tij ka reaguar kreu i AAK-së, Ramush Haradinaj. Ai ka thënë se është thellësisht i pikëlluar nga lajmi për vdekjen e Agronit. "Agroni një jetë të tërë ishte në shërbim të atdheut, para lufte, në luftë e në paqe. Bashkë me të vëllanë, Nasimin, angazhimin për vendin e kishte trashëguar nga i ati, Smajl Haradinaj. Ai ishte i burgosuri politik më i ri në moshë në Jugosllavinë e atëhershme, ndërsa u shqua si një ndër luftëtarët më të zotë të ushtrisë çlirimtare. Ai kishte kohë që vuante nga një sëmundje e rëndë e shkaktuar nga presioni i eksplodimit të një rakete të hedhur nga aeroplanët e ushtrisë serbe në bombardimet në fshatin Prilep të Deçanit", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".
Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se e ndan dhimbjen me familjen Haradinaj, bashkëluftëtarët, shokët dhe gjithë ata që e njohën Agronin. "I pikëlluar nga lajmi për vdekjen e Agron Smajl Haradinaj, njëri nga ushtarët e orëve të para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Tërë jetën ia kushtoj Atdheut, në luftë e në paqe, ishte i burgosur politik në Jugosllavinë e atëhershme dhe nga ushtarët më të zotë të UÇK-së. Ndaj dhembjen me familjen Haradinaj, bashkëluftëtarët, shokët dhe gjithë ata që e njohën", ka shkruar Ramosaj në "Facebook".
Ngushëllime ka shprehur edhe deputeti i PDK-së, Xhavit Haliti. "Më la pa fjalë lajmi për vdekjen e Agron Haradinajt. Agroni qysh si i ri e ndoqi traditën familjare në rrugën e atdhedashurisë. Ishte një nga të burgosurit politik më të ri në moshë, kurse gjatë luftës çlirimtare një nga ushtarët e parë të UÇK-së. Ngushëllime familjes Haradinaj, bashkëluftëtarëve, miqve dhe shokëve të Agronit! Agron, u prehsh në paqe!", ka shkruar Haliti në "Facebook".
Edhe ushtruesi i detyrës i kryetarit të OVLUÇK-së, Faton Klinaku, ka thënë se i ndjeri Agroni prej vitesh po vuante nga një sëmundje e rëndë. "Sapo morëm lajmin e hidhur se ndërroj jetë bashkëluftëtari ynë Agron Smajl Haradinaj. I ndjeri vuante prej shumë vitesh nga një sëmundje e rëndë dhe trajtohej jashtë shtetit. Agroni një jetë të tërë ishte në shërbim të Atdheut, para lufte, në luftë e në paqe. Bashkë me të vëllanë Nasimin, angazhimin për vendin e kishte trashëguar nga i ati Smajl Haradinaj. Ai ishte i burgosuri politik më i ri në moshë në Jugosllavinë e atëhershme ndërsa u shqua si njëri ndër luftëtarët më të zotë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për ceremoninë e varrimit do të njoftoheni. Në emër të OVLUÇK-së i shprehim ngushëllime familjarëve, bashkëluftëtarëve, shokëve e miqve! Lavdi jetës dhe veprës së tij!", ka shkruar Klinaku në "Facebook".
Bardhyl Mahmuti, kryetar i Qendrës "Gjenocidi në Kosovë Plagë e Hapur", ka thënë se me pikëllim ka marrë lajmin për vdekjen e Agron Ismajl Haradinajt. "Sëmundja nga e cila lëngoi viteve të fundit ishte rezultat i vuajtjeve që i shkaktoi pushteti në burgjet serbe dhe jeta në kushte të okupimit. Ngushëllimet më të përzemërta Familjes së lavdishme Haradinaj,



Naimit, Shqipes dhe sidomos Nasimit që padrejtësisht mbahet prapa grilave! Ngushëllime të gjithë bashkëluftëtarëve të Agronit! Lavdi luftëtarit të shquar të çështjes kombëtare, Agron Ismajl Haradinaj!", ka shkruar Bardhyl Mahmuti në "Facebook".

REAGIM I KMDLNJ-SË

# Gjykata Speciale vazhdon shkeljen e drejtave të njeriut

Gjykata Speciale Ndërkombëtare për Kosovën me seli në Hagë, Holandë publikoi dje një listë të personave të vrarë gjatë dhe pas përfundimit të luftës në Kosovë, serbë dhe shqiptarë për të cilët pretendon se përgjegjësi penale kanë Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi ndaj të cilëve ka filluar një proces gjyqësor. Në pamundësi të ndërtojë një hierarki komanduese ushtarake dhe përgjegjësi politike, Gjykata Speciale Ndërkombëtare ka ndërtuar një skemë duke i akuzuar të arrestuarit se janë pjesë e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale e që kanë përgjegjësi për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Lista që u botua dje burimin apo origjinën e ka te Sigurimi shtetëror i Serbisë përkatësisht Prokurorisë Speciale për Krime Lufte të Serbisë të cilët, pastaj ia kanë dorëzuar Prokurorisë Speciale në Hagë përkatësisht ish-kryeprokurorit, Jack Smith.
Realisht, në pjesën e redaktuar ka emra të tjerë që Prokuroria i ka kursyer për më vonë. Për aktivistë që janë marrë me krime lufte dhe pasoja të luftës, këta dhe emrat e redaktuar janë të njohur kurse për disa që janë në listën e të vrarëve ka pasur të dyshuar, të arrestuar, të dënuar dhe të liruar. Gjykata Speciale Ndërkombëtare për Kosovën, së bashku me Prokurorinë



Speciale që nga fillimi i procesit ka shkelur të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria siç janë përkthimi gjatë paraqitjes para gjykatës, mospërkthimi me kohë apo përkthimi i pjesshëm e materialeve që ka ndikuar që të akuzuarit të mos jenë në gjendje të përgatisin një mbrojtje efektive ashtu siç e parasheh ligji. Fshehja e materialeve shfajësuese, mospranimi i dëshmitarëve të propozuar nga të akuzuarit dhe mbrojtja, sidomos të politikanëve ndërkombëtarë që kanë shërbyer në Kosovë ishte shkelje që përmbajtësisht pakëson mundësitë për mbrojtje. Kurdisja e dëshmitarëve në bashkëpunim me autoritetet serbe është mbajtur jashtë syve të opinionit për ta fshehur fragjilitetin e akuzave që mbështetet në burimet e atyre që kanë kryer krime në Kosovë. Deklarimet publike të kryeprokurorit Smith se të akuzuarit mund dhe do të dënohen me burgim të përjetshëm është shkelje flagrante e parimit të prezumimit të pafajësisë dhe me qëllim që të dërgohet një porosi në opinion për rrezikshmërinë dhe kriminalizimin e të akuzuarve, pa një vendim të prerë të gjykatës përkatëse e që nënkuptohet si presion ndaj opinionit dhe gjykatës. Deklaratat akuzuese të kryetares së kësaj Gjykate të Inkuizicionitt Special sipas parimit etnik ndaj të akuzuarve janë të papërgjegjshme, paragjykuese, ndikuese dhe në kundërshtim me të drejtat e njeriut. Kujdesi i pamjaftueshëm shëndetësor, ushqimi që nuk përputhet me nevojat e të burgosurve, mbajtja në veçim i Salih Mustafës janë në kundërshtim me të drejtat që iu takojnë si persona të privuar nga liria. Trajtimi që iu bëhet gjatë vizitave "humanitare" është degradues dhe shkelë rëndë dinjitetin e të burgosurve. Mbajtja aq gjatë në paraburgim tejkalon afatet e arsyeshme që parashihen me dokumentet ndërkombëtare për të privuarit nga liria. Krijimi dhe dhënia e monopolit apo ekskluzivitetit për monitorim vetëm për Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe Ombudspersonin e Holandës është përjashtues, mosnjohje dhe mospranim i një konteksti kosovar e që për të burgosurit është i mirëseardhur. Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati janë dënuar me dënime kapitale për rrezikim të dëshmitarëve shkaku se paskan bërë përpjekje ta bëjnë të njohur identitetin e dëshmitarëve të mbrojtur dhe bashkëpunues.
Në anën tjetër, me bërjen publike të emrave të të vrarëve, pa u shqyrtuar gjatë procesit gjyqësorë, qind për qind rrezikohen jetët e dëshmitarëve për faktin se shumë dëshmitarë janë familjarë të të vrarëve. Duket se qëllimi i Gjykatës Ndërkombëtare Speciale është ky; të vritet ndonjë dëshmitarë apo edhe të kërcënohet në mënyrë që të krijohet alibi për refuzim të çdo kërkese për lirim nga paraburgimi, të vërtetohet fajësia dhe rrezikshmëria e të akuzuarve përmes këtyre incidenteve të mundshme dhe të shkaktohen hasmëri dhe vrasje midis shqiptarëve. Gjithashtu, me theksimin e një rasti ku një deputet i parlamentit qenka kërcënuar me vrasje nga njëri i akuzuar, qëllimi është të përkrahet një luftë brenda subjekteve politike, të vërtetohet se kjo ishte bërë për qëllime politike dhe të ndërlidhet me vrasjet tjera të quajtura politike, pa asnjë vendim të formës së prerë të gjykatës. Po të dilte dikush nga aktivistët që ka njohuri për këto vrasje dhe ngjarje para se doli Gjykata Ndërkombëtare Speciale për Kosovën në Hagë, përveç bastisjeve dhe konfiskim të materialeve, pa asnjë dyshim do të kishte të arrestuar dhe do të sajohej një proces gjyqësor sikur ndaj Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt. Gjykata Speciale Ndërkombëtare për Kosovën në Hagë po e luan një lojë të ulët duke iu përshtatur nevojave dhe proceseve politike, po i shkelë në mënyrë të lakuriqur të drejtat e njeriut duke dhunuar të gjitha ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria. Duhet të jesh, së paku i marrë e të besoni për një proces të drejtë, të paanshëm dhe të pandikuar politikisht apo grupet e caktuara të interesit!



KRYEMINISTRI ALBIN KURTI KA RAPORTUAR PARA KUVENDIT PËR TAKIMIN E FUNDIT NË BRUKSEL ME PRESIDENTIN SERB ALEKSANDËR VUÇIQ

# Pranimi i planit evropian ‘përplas’ pozitën dhe opozitën në Kuvend

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka thirrur të enjten seancë parlamentare që kryeministri Albin Kurti të raportojë në lidhje me propozimin evropian për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, në veçanti preambulën e tij. Lumir Abdixhiku, që ishte propozuesi i mocionit për mbajtjen e këtij debati, e kritikoi propozimin evropian për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, në veçanti preambulën e tij. Ndërkaq kryeministri Kurti ka theksuar se fakti që presidenti serb ka refuzuar ta nënshkruajë marrëveshjen bazike në Bruksel, mund të nënkuptojë përgjigjen për pyetjen se kujt i konvenon më shumë kjo marrëveshje

EPOKA E RE Mal QORRAJ

Prishtinë, 2 mars - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka thirrur të enjten seancë parlamentare që kryeministri Albin Kurti të raportojë në lidhje me propozimin evropian për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, në veçanti preambulën e tij, për të cilën ishin pajtuar ai dhe presidenti serb Aleksandër Vuçiq në Bruksel.

Partitë opozitare kanë dhënë kritika ndaj kryeministrit Kurti në lidhje me tekstin e këtij propozimi evropian.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në fjalimin e tij në Kuvendin e Kosovës në lidhje me dialogun Kosovë - Serbi të enjten, ka thënë se presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, nuk pajtohet me përmbajtjen e propozimit evropian për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve. “Pranimi bëhet vetëm përmes nënshkrimit të të dyja palëve. Refuzimi për ta nënshkruar është tregues që ata nuk janë dakord me përmbajtjen”, ka thënë Kurti, duke iu referuar takimit të nivelit të lartë mes tij dhe Vuçiqit në Bruksel, më 27 shkurt, ku u diskutua propozimi evropian. Teksti i këtij propozimi, që Bashkimi Evropian e ka quajtur një marrëveshje bazë, është publikuar mbrëmjen e 27 shkurtit.

Pas takimit në Bruksel, përfaqësuesit e BE-së si lehtësues të dialogut thanë se edhe Kosova edhe Serbia e kanë pranuar tekstin e kësaj marrëveshjeje bazë dhe pritet në vazhdim të diskutohet për planin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë më 28 shkurt se Serbia është e gatshme të punojë në shumë gjëra që dalin nga propozimi evropian për normalizimin e raporteve mes Kosovës dhe Serbisë. Megjithatë, ai shtoi se nuk do të bisedojë për “njohjen reciproke, njohjen dhe anëtarësimin e Kosovës në Kombet e Bashkuara”.

I pyetur gjatë një interviste për nenin që thotë se Serbia nuk do ta bllokojë Kosovën të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare, Vuçiqi tha: “Prandaj nuk e nënshkrova [propozimin evropian]”.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, që ishte propozuesi i mocionit për mbajtjen e këtij debati, e kritikoi propozimin evropian për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, në veçanti preambulën e tij. Ai tha se preambula e këtij propozimi që ndër të tjera përmban tekstin “për ta kapërcyer trashëgiminë e së kaluarës” dhe “pa paragjykuar pozicionet e ndryshme të palëve në lidhje me çështjet themelore, përfshirë çështjet e statusit”, paraqet dëm historik për Kosovën. “Në një rast të paprecedent Kosova pajtohet me paragjykimin rreth statusit të vet politik…”, ka thënë Abdixhiku.

Në anën tjetër, në fjalimin e tij Kurti tha se ky konstatim është gabim. “Sa i përket qëndrimit që ‘overcome the past’ [tejkalimi i së kaluarës] është falje e krimeve të Serbisë... ky qëndrim është i pasaktë, i padrejtë, i pavërtetë. Një ndër qëndrimet e mia ka qenë që një marrëveshje bazike pa elemente të drejtësisë tranzicionale nuk mund të bëhet”, ka deklaruar Kurti.

Kryeministri Kurti ka theksuar se fakti që presidenti serb ka refuzuar ta nënshkruajë marrëveshjen bazike në Bruksel, mund ta nënkuptojë përgjigjen për pyetjen se kujt i konvenon më shumë kjo marrëveshje.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë se nëse analizohen nenet e kësaj marrëveshjeje, vihet në përfundime dëshpëruese. Sipas Krasniqit, Neni 7 është një nga nenet më problematike sesa Neni 10 ku flitet për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. “Neni 7 nuk flet për kompetenca të vetëqeverisjes lokale sepse këto i kanë komunitetet e Kosovës bazuar në Pakon e Ahtisarit, nuk flet as për konventën e kornizës për vetëqeverisjen lokale, sepse në draftin e kaluar ka qenë e theksuar kjo konventë - kornizë. Sot flet për instrumentet e Këshillit të Evropës. Pra, Neni 7 rrezikon të sjellë një autonomi politike dhe substanciale”, ka deklaruar Krasniqi.

Ndërkaq, nëse analizohet preambula e kësaj marrëveshjeje, sipas Krasniqit, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është pajtuar ta kapërcejë trashëgiminë e së kaluarës. “Kjo i bie që ne po e kapërcejmë pa e trajtuar [trashëgiminë e së kaluarës] siç kemi kërkuar vite me radhë - [çështje] si adresimi i përgjegjësive penale për krimet e luftës që i ka bërë Serbia në Kosovë, dëmshpërblimet e luftës, kompensimin e viktimave të luftës, zbardhjen e personave të pagjetur, kthimin e të mirave materiale e të tjera”, ka thënë Krasniqi.

Nga situata e para dy vjetëve, tha Krasniqi, kur aleatët e Kosovës flisnin për marrëveshje finale me njohje në qendër, kryeministri Kurti ka përfunduar në një kompromis të rëndë në një marrëveshje të përkohshme me Asociacionin në qendër.

“Kryeministër, askush nuk po të akuzon për tradhti, por marrëveshja nuk është e mirë. Nga një marrëveshje finale me njohjen e ndërsjellë në qendër, keni sjellë një marrëveshje të përkohshme me asociacionin në qendër. Ndoshta edhe me autonomi në qendër”, është shprehur Krasniqi.

Besnik Tahiri, shef i grupit parlamentar i partisë opozitare, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ka theksuar se partia e tij e mbështet propozimin evropian “duke pasur parasysh rrethanat në të cilat gjendet Kosova”. “Padyshim që ky propozim ka të metat e veta, por e ka marrë mbështetjen tonë pasi në rrethanat në të cilat gjendet Kosova, shënon një kapitull të rëndësishëm në njohjen e Kosovës”, ka thënë Tahiri, duke shtuar se kjo nuk do të thotë se e mbështetin Albin Kurtin dhe qeverinë e tij.

Marrëveshja për Asociacionin është një ndër pikat më kundërthënëse në dialogun Kosovë - Serbi. Kurti ka përsëritur disa herë qëndrimin e tij se nuk pajtohet me themelimin e një asociacioni njëetnik dhe me kompetenca ekzekutive, që do të ishte në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. “Nëse më pyesni se a duhet zbatuar ato (marrëveshje) që i gjithë komuniteti ndërkombëtar i aleatëve pret që të zbatohen, përgjigjja ime është po, por vetëm nëse zbatohen të gjitha në përputhje me përcaktimet kushtetuese të Republikës së Kosovës. Nuk lejoj përjashtime, fokusime e veçime në një (marrëveshje)”, ka thënë Kurti.

Shefja e grupit parlamentar e Vetëvendosjes, Mimoza Kusari, ndërkaq u shpreh se marrëveshja nga subjektet opozitare po kundërshtohet “se duan të kundërshtojnë”, por jo se kanë parime që listojnë për ta kundërshtuar marrëveshjen. Ajo ua përmendi atyre një moratorium njëvjeçar, që ishte në kuadër të marrëveshjes që Kosova dhe Serbia kanë nënshkruar në Uashington në shtatorin e vitit 2020. Në bazë të atij moratoriumi, Kosova nuk do të aplikonte për anëtarësim në institucione e organizata ndërkombëtare, ndërkaq Serbia do ta ndalte fushatën për tërheqjen e njohjeve të pavarësisë së Kosovës. “Kjo marrëveshje thotë në asnjë organizatë ndërkombëtare Serbia nuk mund ta pengojë Kosovën të aplikojë. Asnjë. Zero”, ka thënë Kusari para deputetëve.

# Komunat kërkojnë rishikimin e afatit të raportimit për përmbushjen e obligimeve nga agjenda evropiane

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 MARS - Asociacioni Komunave i Kosovës (AKK) ka organizuar takimin e radhës të Kolegjiumit të Zyrtarëve Komunalë për Integrime Evropiane (ZKIE) në kuadër të koordinimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të parapara në funksion të realizimit të planit të punës. Edhe një herë zyrtarët komunalë për integrime evropiane diskutuan për sfidat për përmbushjen e aktiviteteve dhe punës që e pret kolegjiumin këtë vit.

Në fillim të takimit, Gani Berisha, menaxher i programit në AKK, i ka njoftuar anëtarët e Kolegjiumit për Integrime Evropiane për aktivitetet konkrete që janë zhvilluar në vitin e kaluar, respektivisht për rolin e Asociacionit të Komunave të Kosovës në aktivitetet lobuese, përfshirë hartimin e kërkesave dhe rekomandimeve që dalin nga strukturat e AKK-së, me objektiv të qartë përmirësimin e shërbimeve të vetëqeverisjes lokale në nivel vendi.

Në këtë takim është theksuar se zbatimi i Rregullores nr. 08/2011 për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrave komunale për integrime evropiane mbetet sfidë në zbatimin e plotë, ku specifikon se zyrat për integrime evropiane shtrihen në të gjitha komunat dhe janë përgjegjëse për koordinimin e procesit në zhvillimin e kornizës rregulluese të politikave të komunës që ndërlidhen me procesin e integrimit evropian.

Një ndër temat e trajtuara ishte edhe afati i paraparë në raportimin periodik te Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në përcaktimin e veprimeve në fushat të cilat komunat janë përgjegjëse, me qëllim përmirësimin e arritjeve komunale në procesin e integrimeve evropiane.

Kërkesë e qartë e zyrtarëve komunalë për integrime evropiane ishte që afati i raportimit duhet të jetë (15-31 janar dhe 15-31 korrik) me qëllim të informimit të duhur në fusha të ndryshme të procesit të integrimit evropian në nivel lokal.

Bashkëpunimi në mes të nivelit qendror dhe atij lokal mbetet për t'u dëshiruar sa i përket diskutimit të çështjeve që ndërlidhen me procesin e integrimit evropian të Kosovës. Anëtarët e kolegjiumit edhe një herë kërkuan shtimin e koordinimit reciprok të aktiviteteve me MAPL-në përmes angazhimit të mirëfilltë në zbatimin agjendës evropiane.



# Vetingu në drejtësi, Konjufca i dërgon në Kushtetuese amendamentet që lidhen me këtë proces




PRISHTINË, 2 MARS - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka njoftuar se i ka përcjellë në Gjykatën Kushtetuese amendamentet kushtetuese lidhur me vetingun në drejtësi.

Në "Facebook", Konjufca ka shkruar se vetëm përmes vetingut Kosova do të jetë shtet i së drejtës. "Në përputhje me përgjegjësitë kushtetuese dhe pas përfundimit të punës së Komisionit Ad Hoc për vetingun në sistemin e drejtësisë, sot i kam përcjell amendamentet Kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese për të marrë përgjigje nëse të njëjtat janë në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Jam i gëzuar që reforma në drejtësi është në rrugë të mbarë. Vetëm përmes saj Republika e Kosovës do të jetë shtet i së drejtës dhe do të kthehet besimi i qytetarëve në institucionet e drejtësisë", ka shkruar Konjufca.

Kryeparlamentari i ka falënderuar anëtarët e Komisionit Ad Hoc, përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të drejtësisë, partnerët dhe ekspertët për punën e tyre në këtë proces të rëndësishëm.

E ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, e ka quajtur lajm shumë të mirë dërgimin e amendamenteve kushtetuese në gjykatë. "Lajm shumë i mirë dërgimi në Gjykatën Kushtetuese i amendamenteve kushtetuese për vetingun në sistemin e drejtësisë. Falënderoj Kuvendin për bashkëpunimin në këtë proces të rëndësishëm!", ka shkruar Haxhiu në "Facebook".

# VLERËSIMI PËR ADEM DEMAÇIN NGA FOLEJA E QYQES



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**As e para e as e fundit:** Më 26 shkurt ishte ditëlindja e Frymëzuesit, Sakrifikuesit, Kuptimit për Liri, Çlirim dhe Bashkim Kombëtar, të Papërsëritshmit dhe të Amshueshmit Bacë Adem Demaçi që më shumë se 28 vjet, në llogoret e ish-Jugosllavisë, kreu në mënyrën më të ndershme detyrën që ia ka caktuar, me të lindur i Madhi Zot, të luftojë për liri të njerëzimit që ishte në robëri, në përgjithësi dhe për lirinë e shqiptarëve, popull i robëruar e që asnjëherë nuk e ndali përpjekjen dhe luftën për liri dhe bashkim kombëtar, pa pyetur për çmimin që duhej paguar dhe e pagoi. Për Bacën burgu nuk ishte vuajtje, por ishte detyrë që vullnetarisht e zgjodhi dhe asnjëherë nuk u ankua për "fatin e keq" duke e shndërruar në një ecje mësimi dhe lundrim drejt lirisë. Në të njëjtën kohë i kreu të gjitha shkollat, fakultetet dhe akademitë shkencore në kuadër të mundësive sikur që edukoi me atdhetarizëm qindra e dhjetëra mijëra atdhetarë, të dënuar politikë, por edhe për vepra të tjera. Nga një familje e varfër materialisht, por e pasur shpirtërisht, që ajrin, ujin dhe ushqimin i kishin atdhedashuri, i rritur pa Baba për t'u bërë Baba i të gjithë atdhetarëve, Adem Demaçi nuk kishte asnjë mëdyshje gjatë përcaktimit midis Nënës Nazife dhe Nënës Shqipëri duke u përcaktuar për Nënën e Përjetshme dhe të Përmotshme; Nënën Shqipëri, i bekuar nga Nëna që e rriti në kushte jashtëzakonisht të vështira, Nëna Nazife. Në kohën kur shqiptarët nuk guxonin të deklaroheshin si shqiptarë dhe kur Serbia ua kishte caktuar një atdhe tjetër, shkretëtirat e Anadollit në Turqi, Baca Adem, djalin e vetëm e emëroi Shqiptar kurse vajzën, gjithashtu të vetme, Abetare. Në kohë shumë të re e shkroi romanin kundër vëllavrasjes dhe shpërnguljes për Turqi, "Gjarpijt e gjakut", që u bë abetare dhe Akademi për të gjithë ata që e gjakonin lirinë dhe bashkimin kombëtar si qëllim dhe kuptim të jetës. "Jo atyre që janë trima të ngrejnë gishtin e krimit, por atyre që janë burra të shtrijnë dorën e pajtimit". Çka mund t'i shtohet kësaj filozofie njerëzore, kombëtare, politike dhe morale sot, pas 100 vjetëve, 1000 e më shumë vjetëve, sa të ketë popuj, histori dhe përjetësi! Tek ata me mendësi dhe kod gjenetik të përshtatur që robërinë ta konsiderojnë si liri për shkak të robërisë së gjatë, por edhe përcaktimit personal, familjar dhe shoqëror, si zgjedhje e tyre shkaku i përfitimeve, në radhë të parë materiale, por edhe mundësi të mbijetojnë dhe jetojnë në një "liri" të pajetueshme, personaliteti, si ai i Bacës Adem Demaçi, si rast unik dhe i papërsëritshëm, në këtë botë dhe në botën e amshueshme, megjithatë janë një zile për ndërgjegjen e tyre të kalibruar sipas rregullave të robëruesit. Po ç'më shtyri të shkruaj pikërisht tani dhe për këtë temë?

**Të mallkuarit nga ligështitë e mendjes së krisur:** Pikërisht kur përfundonin përgatitjet për festimin e ditëlindjes së Bacës Adem Demaçi që ishte marrë përsipër nga Nuhi Ahmeti, ish-i burgosur politik, shok i pandarë deri në kalim në amshim të Bacës e që një pjesë të jetës e kishte kaluar në llogoret e ish-Jugosllavisë me Bacën, që besoj se nuk e ndërron me asgjë sikur edhe ne të tjerët që e patëm të njëjtin fat, një shok imi shumë i mirë më dërgoi një shkrim me shumë mllef dhe me koment "shihe një idiot me emrin Pal Shtufi, sigurisht mercenar nga Shqipëria çka ka shkruar për Bacën Adem...". E lexova shpejt dhe u pajtova pjesërisht me shokun sa i përket cilësimit, ndërsa jo edhe gjeografisë për faktin se nuk ishte nga Shqipëria, por nga rrethi i Prizrenit, kryeqytetit kulturor dhe historik i shqiptarëve, ku aty-këtu gjendet edhe ndonjë horr, sikur edhe në vendet e tjera. Këtë shokun tim e ka mashtruar emri dhe mbiemri i këtij Pal Shtufit, ndërsa unë pata lexuar më herët për të për madhërimin që i bënte presidentit të nënshtrimit dhe mënyrës shpotitëse dhe përbuzëse ndaj luftës së të lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës. Në paraqitjet mediatike veten e portretizonte si veprimtar të madh të çështjes kombëtare që nga viti 1980 kur qenka arrestuar si marksist-leninist, pa u dorëzuar asnjëherë përkundër rreziqeve të mëdha për jetën dhe sigurinë e Palit, tash të konvertuar si Apostuli Pal i çështjes kombëtare, Apostuli Pal Shtufi. Madje, sipas historiografëve të shquar, kronistëve të kohës dhe burimeve të besuara arkivore, Pal Shtufi luftën më të madhe kundër regjimit të Serbisë e ka bërë në Zvicër gjatë periudhës 30 vjeçe, si ikanak, dhe se lufta e UÇK-së është e papërfillshme me luftën e Palit. Frymëzimin, në vend se ta kishte marrë nga babai i tij, një atdhetar dhe nacionalist i bindur e që do ta bënte krenar, e mori nga presidenti historik i nënshtrimit, të cilin në një shkrim, me pak fjalë dhe shumë ligështi. mundohet ta përballë me Vullkanin e Çështjes Kombëtare, Bacën Adem Demaçi, duke e fyer në mënyrën më të poshtër të mundshme. Nuk më ka rënë në jetën time që brenda një shkrimi, as të një faqeje të këtë aq fyerje, aq të pavërteta, aq poshtërime ndaj një Vlere Njerëzore dhe Kombëtare, të përmasave globale siç është Ylli i Pashuar Ndriçues, Baca Adem Demaçi. Këso sulmesh nuk pati bërë as Eskadroni Politik për Pushkatim Njerëzor, Kombëtar dhe Politik që e kishte formuar LDK-ja, pjesa jugosllave dhe proserbe, që u aktivizua në vitet '90, pasi u lirua Baca Adem Demaçi nga dënimi i tretë prej më shumë se 28 vjetëve, me denoncimin dhe dëshminë e disave që e vizituan Bacën pas daljes nga burgu apo me spiunllëqet dhe dëshminë e paraardhësve biologjikë të këtyre që e vizituan Bacën e që ishin pjesë e organizatës ilegale që udhëhiqej nga Baca Adem. Për t'i kursyer fëmijët e tyre, Baca Adem nuk doli botërisht, por se la dëshmi të mjaftueshme.

**Po çka tha Pali në shkrimin DEMAÇI vs RUGOVA:** Për ta krijuar një mbulesë morale për një shkrim të poshtër, Pal Shtufi tha se e paska vizituar, bashkë me një mercenar tipik dhe klasik, Bacën pasi qenka liruar nga burgu dhe se pas disa vizitave njohëse apo skanimi të porositur, krejt çka mbeti ishte respekti për patriotizmin dhe sakrificën e gjatë të tij, asgjë tjetër. E kush e thotë këtë, një ikanak dhe një frikacak, i frymëzuar nga presidenti historik i nënshtrimit dhe i ndikuar nga denoncuesit dhe dëshmitarët në proceset gjyqësore kundër Bacës Adem dhe patriotëve të tjerë. Një numër i vizitorëve që vizituan Bacën në atë kohë ishin si "Posta e Porositur" e shkruar nga një urryes i madh i Bacës e që nuk i mjaftonte të shkruajë kundër Bacës, por para kamerave thoshte se: "se më mirë ka qenë që Adem Demaçi të vdiste në burg që shpërfaqte edhe dëshirën e krahut proserb dhe projugosllav të LDK-së". Shpresoj se Pal Shtrumfi të mos jetë i tillë.

**Demaçi intelektual sipas Pal Shtrumfit:** Në përpjekje për ta ulur, deri në përbuzje intelektualisht Bacën Adem Demaçi, cilësimi i Palit është se niveli intelektual i Bacës është i një niveli të mësuesit të kohës për faktin se paska qenë i izoluar 28 vjet dhe se në vitet '90 paska qenë 30 vjet pas të tjerëve duke mos treguar kush janë të tjerët apo duke nënkuptuar me këtë presidentin historik të nënshtrimit dhe spurën proserbe dhe projugosllave që e shoqëronin deri në ikjen në shtetet perëndimore. Pal Shtrumfi thotë, në denoncimin e ulët ndaj Bacës, se mosnjohja e gjuhëve të huaja, fryma politike e asaj Evrope dhe mangësitë intelektuale, e gjymtonin Demaçin edhe si iluminist duke vazhduar se Pali lehtësisht paska vlerësuar nivelin intelektual të Bacës për të vazhduar se ky nivel qenka i një →



politikani të rëndomtë të kohës. Me Rugovën, thotë Pali, as që mund të krahasohej. E këtu edhe unë pajtohem me Palin; vetëm një i marrë, qëllimkeq, ndryshk njerëzor dhe moral i vë në një rrafsh Frymëzimin për Liri, Vetëmohuesin për të Mirën e Përgjithshme që tërë jetën ia ka kushtuar luftës për liri me një udhëheqës shpirtëror të Palit që nuk ka qenë në gjendje ta prishë as tymin e duhanit e lërë më diçka më tepër si, p.sh., largimin e maces nga përsheshi. Adem Demaçi ka hyrë në burg si intelektual i formuar dhe një shkrimtar i jashtëzakonshëm. Edhe të mos bënte asgjë tjetër në jetë, vetë fakti se ishte autor i "Gjarpijve të gjakut" në kohën kur gjarpijt e gjakut nuk ishin vetëm okupatorët serbë dhe jugosllavë, por edhe shumë shqiptarë që u shërbenin këtyre gjarprinjve, si hardhuca dhe hiena e që edhe sot i gëzojnë gjitha të mirat, qoftë si mumie biologjike apo në trajtën e zgjatimeve politike të pasardhësve të tyre e që janë vendosur në të gjitha nivelet e pushtetit, mjafton që Adem Demaçi ta fitojë përjetësinë. Gjarpijt e gjakut ishin kushtrimi, himni, flamuri, alfabeti, oda dhe Akademia Kombëtare dhe Politike për të gjithë ata patriotë që e donin lirinë. Këtë e kishte shkruar mësuesi i kohës, intelektuali i nivelit nën mesatar dhe i gjymtuari intelektual sipas skanuesit të potencialit intelektual i shtytur nga kureshtja shkencore apo asaj UDB-ore, në personalitetin e hulumtuesit - hetuesit, Pal Shtrumfit. Nëse dikush bëhet intelektual vetëm se ka qenë kursist i Kumrovcit apo që ka fituar tituj nga regjimi për t'i shërbyer regjimit dhe kundër popullit që i takon, Adem Demaçi nuk i takon kësaj kotille intelektuale. Ti, Pal Shtrumfi, as nuk mund të imagjinosh se sa ka lexuar Adem Demaçi, literaturë, romane, nga politika, ekonomia, filozofia etj. Bibliotekat e burgjeve në Jugosllavi kanë qenë mirë të furnizuara dhe njohësit e gjuhëve sllave kanë mundur të lexojnë thuaja të gjithë autorët më të njohur të botës të të gjitha profileve. Adem Demaçi e ka njohur mirë gjuhën serbokroate, turke, ka komunikuar dhe shkruar në gjuhën angleze sikur që ka komunikuar mjaftueshëm në gjuhën frenge. Kurse, këta intelektualët tuaj që paskan qenë 30 vjet para Bacës Adem janë shquar si denoncues, dëshmitarë, spiuj dhe terrorizues të popullit që i kanë takuar.



**Demaçi kishte mendësi marksiste:** Formimi politik i Bacës Adem nuk kishte as mendësi e as përmbajtje marksiste, por qind për qind kombëtare që vërehet në krijimtarinë e tij letrare, intervistat e shumta, esetë politike dhe paraqitjet tjera publike. Ishte çështje tjetër se shqiptarët, pavarësisht përcaktimit politik i kishin vetëm dy mundësi; për Josip Broz Titon ose për Enver Hoxhën. Titon e njihnim si gjakpirës dhe kriminel ndërsa Enver Hoxhën nga fjalimet. Në aspektet tjera për ne ishte i panjohur. Po ishe apo nuk ishe me Enver Hoxhën, gjykatat serbe dhe jugosllave automatikisht na dënonin si enveristë shkaku se dashurinë tonë për Shqipërinë e identifikonin me Enver Hoxhën. Dy herë jam dënuar politikisht 3 + 12 vjet dhe më kanë cilësuar si enveristë ndonëse kurrë nuk kam qenë enveristë por, thjesht një nacionalist i bindur dhe nuk kam qenë urryes i popujve tjerë. Për aq kohë sa kam qenë bashkë me Bacën Adem në llogoren në Stara Gradishkë (Kroaci) asnjëherë nuk e kam parë të ketë lexuar ndonjë literature leniniste apo komuniste dhe kurrë nuk e kam dëgjuar të ketë kënduar këngë apo marshe komuniste por gjithmonë këndonte për Ded Gjon Lulin, Mehmet Shpendin, Kamer Loshin sikur edhe këngë të vjetra qytetare dhe polifonike nga jugu. Serenatat korçare ishin shpirti i muzikës për Bacën ndërsa ka qenë njohës dhe adhurues i jashtëzakonshëm i muzikës klasike. Bacës Adem nuk i ka interesuar aspak ideologjia. Veprat e mëdha në fushën e artit, letërsisë, kulturës, politikës, filozofisë, mjekësisë, astronomisë, gjeografisë dhe të tjera nuk janë krijuar nga intelektualë me tru të formatizuar për të shërbyer okupatorit, sikur këta të Palit por ata që edhe përmes këtyre veprimeve kanë kontribuar për të mirën e njerëzimit dhe popullit që i takojnë, dhe, për ironi kryesisht sa ishin në izolim, syrgjynosje, dëbim nga vendlindja apo të arrestuar, që nga Epikteti, Seneka, Ciceroni, Sokrati, Platoni, Dostojevski, Sartri, Ezra Paund, Orhan Pamuk, Sallman Ruzhdi, Makiaveli, Dante Aligeri, Françesko Petrarka, mos a zgjasë listën, e deri te kolosët e mendimit filozofik dhe kombëtar shqiptar, Ukshin Hoti dhe Adem Demaçi. Ky i yti nuk bënë pjesë asgjëkund ndonëse kishte aktivitet të bujshëm në proceset e diferencimit politik.

**Demaçi, politikisht i lajthitur:** Me këtë "diagnozë" prej një ndryshku njerëzor dhe moral, Pal Shtufi, e përmbyllë qarkun e parë, sigurisht edhe jo të fundit të urrejtjes patologjike dhe përpjekjes për zhvleftësim të veprimtarisë mbi 60 vjeçare kombëtare, politike dhe letrare të Bacës Adem, për ta himnizuar Rugovën, një oportunist, i pavendosur dhe kundërshtar i çdo nisme për ta dinamizuar lëvizjen kombëtare dhe politike të shqiptarëve dhe penguesi më i madh i luftës çlirimtare, deri në kohën kur, përmes Beogradit, në përcjellje të popave të "Shën Exhidios" u strehua në Itali ku i garantohej siguria personale, familjare dhe shpurës që e përcillte e që ishte edhe qëllimi i tij. Herë e cilëson se ka mendësi marksiste, herë se është nacionalist i tërbuar dhe se çdo politikë e tij ishte e lajthitur duke e akuzuar thuaja si dëmtuesin më të madh të kombit dhe se asnjë këshillë politike nuk i paska qëndruar kohës. Harron qëndrimin dhe fjalët e Bacës Adem në gjykimin e parë që qind për qind e parashikoi shkatërrimin e Jugosllavisë, fjalimin e tij para Parlamentit Evropian gjatë ndarjes së Çmimit Saharov kur saktësisht parashikoi zhvillimet në Kosovë dhe Jugosllavi me një luftë të pashmangshme. Po të njëjtin parashikim i kishte thënë Sekretarit Bejker në Beograd ku ishte bashkë me presidentin e nënshtrimit dhe alter egon e Albinit, Veton Surroi. Ishte antologjik, nga këndi i parashikimit të zhvillimit të ngjarjeve gjatë duelit televiziv me Vuk Drashkoviqin. Parashikimet i kishte shumë të sakta edhe në takimet me Gellbart, Hollbruk, Olbrajt dhe Robin Kuk në Shkup. Dhe shumë të tjera. Të gjitha të zezat që iu kanë ndodhur shqiptarëve, Pal Shtrumfi ia adreson sakrifikuesit dhe luftëtarit më të bindur dhe maratonik për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar, të Pavdekshmit dhe të Papërsëritshmit, Bacë Adem Demaçi. Ky far Shtrumfi thotë se Rugova ishte fati ynë i mirë dhe fat historik. Ia paftë hajrin, Ibrahim Rugovës para Kuvendit të Kosovës dhe Abraham Rugovës para Katedrales në Prishtinë. Ne, shokët, miqtë, bashkëveprimtarët dhe bashkëluftëtarët e Bacës Adem jemi krenar që kemi jetuar në kohën e Bacës sikur që do të jenë krenarë pasardhësit tanë me kujtimin dhe veprën e Adem Demaçit, që do t'i qëndrojë çdo kohe. Juve ju, mbeten kujtimet për Rugovën në bronz dhe në gurë, si përmendore që do i kapë ndryshku dhe do të shemben kur të hapen dosjet e asaj kohe. Deri atëherë, ju që e urreni Bacën Adem dhe e hyjnizoni presidentin tuaj që, në fakt asnjëherë nuk e ka pasur faturën institucionale të presidentit por ka vepruar me profaturë sepse Kosova nuk kishte status të definuar dhe të pranuar politik, mund të merreni me veprat madhore politike të filozofisë rugoviane siç ishin, diferencimet politike që ua bënte kolegëve, duke filluar me Akademik Rexhep Qosen, shkrimet plotë dashuri dhe pasion për Josip Broz Titon dhe vulën e filozofisë politike rugoviane, apo himnin politik në formë të një vjershe të shkurtër të quajtur Titos (Prej fushash e malesh, deri në bregdet. "Të përshëndesim: Na qofsh' me jetë! Tito - mësues, Tito - hero! Kanga për ty, po ndihet kudo)". Në atë kohë, kur presidenti juaj shkruante këtë filozofi rugoviane, Adem Demaçi dhe shumë patriotë të tjerë ishte dhe ishin në llogoret e ish-Jugosllavisë, në kushte dhe rrethana nën çdo dinjitet njerëzor por se nuk u dorëzuan e as nuk u ligështuan asnjëherë! Edhe njeriu më i poshtër, më i ligë dhe më i ulët i vendos veti disa kufij apo standarde të ligësisë dhe poshtërsisë nën të cilat nuk lëshohet. Në rastin e Bacës Adem, në përpjekje për ta diskredituar ulët e më ulët, Pal Shtufi i ka shlyer të gjithë kufijtë, nuk ka njësi matëse që e mate ligësinë e këtij injoranti dhe matrapazi.

Si përfundim, se si ishte trajtuar Baca Adem Demaçi, sa ishte në burg, sa ishte në liri, ditën kur kaloi në përjetësi dhe tani nuk keni përshkrim më të mirë se që e bëri Arbër Ahmeti më 26 korrik 2022 në Rikujtim "Popullit"! (Në katër vjetorin e përjetësimit të kolosit të rezistencës dhe çlirimit kombëtar, i propozoj popullit tonë të krijojë traditën e përvitshme të ngujimit në shtëpi në këtë ditë dhe të mos dalë fare jashtë saj. Kjo mbyllje le ta simbolizon turpin që i ka ra shoqërisë sonë për trajtimin, injorimin, mohimin, e kontributit dhe shpifjet që i kanë hedhur ndaj Bacës Adem prej kohës së burgut e deri ditën që ndërroi jetë. Kjo ditë e mbylljes nga turpi, le të bëhet ditë e reflektimit që atë përbuzje dhe baltosje që tentoi t'ia bëjë Bacit, të mos ua bëjë edhe të tjerëve që kontribuuan e sakrifikuan të gjitha për çlirimin e vendit). Pal Shtufi, ky shkrim i shkëlqyeshëm vlen për njerëzit që kanë turp, prandaj nuk ke nevojë të ngujohesh sepse je Nëna e Paturpësisë!

# Vazhdojnë hetimet për rastin "Brezovica"



**Ferizaj, 2 mars** - Prokuroria Themelore në Ferizaj ka njoftuar se ka filluar një aksion në disa qytete të Kosovës në kuadër të hetimeve lidhur me rastin "Brezovica". "Gjatë këtij aksioni janë kontrolluar dhe bastisur disa autosallone, shtëpi dhe lokale përcjellëse në lokacione të ndryshme", thuhet në një komunikatë për medie nga kjo prokurori.
Aksioni është zhvilluar në qytetin e Prishtinës, të Ferizajt, të Vushtrrisë dhe të Lipjanit për shkak të dyshimit të veprave penale "Fajdeja", "Shmangia nga tatimi" dhe "Detyrimi".
Aksionet për rastin "Brezovica" kanë nisur qysh në fund të vitit 2021.
Deri më tash janë hetuar mbi 100 persona, përfshirë zyrtarë të Ministrisë se Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zyrtarë komunalë dhe pronarë të kompanive private.
Në hetim për këtë rast aktualisht janë edhe 40 persona. Kompleksi turistik "Brezovica", që gjendet në komunën e Shtërpcës, konsiderohet një prej qendrave më të mëdha të turizmit dimëror në Kosovë. Sipas prokurorisë, nga viti 2013 deri në vitin 2022 në këtë qendër janë ndërtuar më shumë se 100 objekte në mënyrë të jashtëligjshme. Për ndërtimin e tyre prokuroria ka thënë se janë dhënë më shumë se dy milionë euro ryshfet.
Në vitet '90 fshati Brezovicë, në pjesën jugore të Kosovës, ishte një prej qendrave më atraktive për turizëm dimëror. Afro tri dekada më vonë kjo qendër e skijimit është shndërruar në një prej aferave më të mëdha të korrupsionit që po heton Prokuroria e Kosovës.
Qindra ndërtime pa leje, degradim i ambientit, dhënie dhe marrje e ryshfetit janë vetëm disa prej veprave penale për të cilat Prokuroria Themelore e Ferizajt ka ngritur dy aktakuza kundër 20 personave.
Të akuzuarit përfshijnë Bratisllav Nikolliqin, ish-kryetar i komunës së Shtërpcës, ku edhe ndodhet Brezovica, pastaj drejtorë komunalë, zyrtarë të Ministrisë së Mjedisit, ndërtues dhe persona të tjerë, që kanë ndihmuar apo kanë dhënë ryshfet në këmbim të lejeve të ndërtimit.
Për këtë rast, në të cilin janë hetuar rreth 100 persona, prokurori Rasim Maloku ka treguar se si Nikolliqi, si kryetar i Shtërpcës, ka dhënë jashtëligjshëm leje për ndërtim në Brezovicë në këmbim të ryshfetit, se si inspektorët komunalë nuk i kanë ndaluar punimet dhe se si zyrtarë të Ministrisë së Mjedisit kanë neglizhuar punën e tyre në raport me degradimin e Parkut Kombëtar "Sharri" në Brezovicë.
Në aktakuzën e parë që është ngritur në vitin 2020 janë përfshirë 11 persona, kryesisht zyrtarë komunalë, ndërtues dhe pronarë objektesh pa leje.
Prokurori i rastit, Rasim Maloku, thotë se sa më shumë që është gjurmuar në këtë rast, aq më shumë janë zgjeruar hetimet.

# ATK-ja lanson projektin kreditimi i TVSh-së




**Prishtinë, 2 mars** - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka lansuar të enjten projektin kreditimi i TVSh-së, që është i gjashti me radhë në vazhdën e projekteve për përmirësimin e përmbushjes tatimore. "Përmes këtij projekti planifikohet të përmirësohet përmbushja tatimore e personave të tatueshëm dhe të regjistruar për TVSh, përfshirë të gjithë faktorët e përcaktuar sipas legjislacionit të TVSh-së me ndikim në kreditimin e TVSh-së. Sipas planifikimeve, ATK do të kryejë aktivitete intensive me qëllim të identifikimit të personave të cilët, bazuar në dispozitat ligjore, nuk deklarojnë saktë kreditimin e TVSh-së", ka njoftuar ATK-ja.
Administrata Tatimore e Kosovës ka përzgjedhur të trajtojë këtë kategori të tatimpaguesve duke u nisur nga fakti se TVSh-ja në raport me tatimet e tjera është tatimi më i rëndësishëm dhe mekanizmi më me ndikim në teorinë dhe praktikën tatimore përmes të cilit realizohet funksionimi i suksesshëm dhe i qëndrueshëm i sistemit tatimor në vend. "Andaj, synimet strategjike të institucionit përmes Projektit për Kreditim të TVSh-së janë përmirësimi i përmbushjes tatimore ose rritja e të hyrave nga TVSh-ja, ulja e hendekut tatimor, të cilat më pas ndikojnë në rritjen e nivelit të përmbushjes vullnetare. Padyshim institucioni çdoherë merr parasysh rekomandimet e dhëna nga FMN për trajtimin e rreziqeve për industritë e selektuara", thuhet në njoftimin e ATK-së.
Administrata Tatimore e Kosovës u ka bërë thirrje të gjithë personave të tatueshëm që t'i përmbushin të gjitha detyrimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor, në të kundërtën do të ndërmerren masat e përcaktuara me legjislacionin tatimor.

## Çalik dhe Holding: Qëllimi i përbashkët, furnizimi i rregullt dhe distribuimi i qëndrueshëm i energjisë

**Prishtinë, 2 mars** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bashkë me zëvendëskryeministrin Besnik Bislimi, kanë pritur në takim kryetarin e Bordit drejtues të Çalik Holding, Ahmet Çalik, kryetarin e Bordit Drejtues të kompanisë Limak, Nihat Ozdemir, si dhe drejtorin ekzekutiv të KEDS-it, Alpin Dogan, me bashkëpunëtorë. Në takim u diskutua për situatën energjetike në vend dhe raportin me KEDS-in në funksion të furnizimit të qëndrueshëm të qytetarëve me energji.
Kryeministri Kurti ka thënë se Kosova është një shtet ku po rriten prodhimtaria dhe eksportet, andaj po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme energjia për bizneset. Kosova ka shënuar një ngritje prej 86-përqindësh në vitin 2021 krahasuar më 2020 në eksporte dhe 23 për qind për vitin 2022 krahasuar më 2021. Çalik dhe Holding theksuan se kompanitë që drejtojnë janë në shërbim të shtetit të Kosovës dhe qëllimi i përbashkët është furnizimi i rregullt dhe distribuimi i qëndrueshëm i energjisë.



## Fillon lirimi i hapësirës publike gjatë rrugës "Ibrahim Mazreku" në Malishevë

MALISHEVË, 2 MARS - Komuna e Malishevës ka njoftuar qytetarët, në veçanti pronarët e objekteve në hapësirën publike gjatë rrugës "Ibrahim Mazreku", se nga e premtja do të fillojë lirimi i hapësirës së uzurpuar publike. "Për lirimin e hapësirës së uzurpuar publike shfrytëzuesit janë lajmëruar me kohë nga komuna, sipas të gjitha procedurave ligjore. Luten të gjithë shfrytëzuesit e këtyre objekteve në hapësirën publike, që t'i lirojnë vullnetarisht këto hapësira dhe t'i largojnë gjërat me vlerë në objektet e tyre, pasi nga nesër do të fillojë rrënimi i tyre dhe lirimi i hapësirës publike. Po ashtu, i njoftojmë të gjithë qytetarët, se lirimi i hapësirës publike do të vazhdojë edhe në pjesët e tjera të qytetit", ka njoftuar komuna e Malishevës.



# Kompania britanike njofton se në dalje të Prishtinës janë 640 mijë tonelata ari

PRISHTINË, 2 MARS - Kompania britanike për hulumtimin e minierave "Western Tethyan Resources" ka njoftuar se në fshatin Slivovë janë 640 mijë tonelata ari. Sipas njoftimit, zona ky dyshohet se mund të ketë ari është rreth 20 kilometra larg Prishtinës. "Zona kryesore në Slivova ka burime të përcaktuara prej 640 kt [640 mijë tonelata] apo 4.8 gr/tonelata ari për 98,700 ons", thuhet në raportin e kompanisë.

Drejtori menaxhues i WTR-së, Mentor Demi, ka theksuar se qasja e kompanisë ka konfirmuar potencialin për projektin e arit në këtë hapësirë. "Jemi shumë të kënaqur me përfundimin e suksesshëm të vlerësimit të biznesit në projektin e arit Slivova dhe me përgatitjet për hyrjen në marrëveshjen definitive të përfitimit me Avrupa Minerals. Qasja jonë sistematike në hulumtim dhe zhvillim të minierave ka rezultuar me konfirmim të resureve me potencial ekonomik dhe konfirmim të potencialit hulumtues për projektin e arit Slivova. Ne mezi presim të ofrojmë njoftime të reja në lidhje me studimin e VPE për projekt, së bashku me rezultatet e tjera hulumtuese në të ardhmen e afërt", ka thënë Demi.

Studimi konceptual i projektit të Slivovës, i përfunduar gjatë fazës së vlerësimit të biznesit, ka sugjeruar për një potencial të një miniere të vogël me opsione të mira menaxhuese të eksploatimit, procesimit si dhe menaxhimit të mbetjeve.



# Dhurohen 40 shtëpi të reja të ndërtuara në lagjen "Frashër"



MITROVICË, 2 MARS - Me ceremoni solemne është bërë dorëzim-pranimi i çelësave për 40 shtëpitë e ndërtuara në fshatin Frashër për familjet me nevojë sociale, projekt ky i realizuar nga Organizata "Qatar Charity" në bashkëfinancim me komunën e Mitrovicës. Me rastin e dhurimit të çelësave morën pjesë kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, drejtori i organizatës "Qatar Charity", Zyra në Kosovë, Esam Dabab, dhe bashkëpunëtorët e tij, drejtorë të drejtorive komunale, drejtori i QKMF-së, "Dr. Nexhat Çuni" dhe familjet përfituese.

Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka thënë se "është nder i veçantë dhe kënaqësi që bashkë me miqtë nga 'Qatar Charity' t'i bëjmë edhe 40 familje me banim, duke e zgjidhur çështjen më jetike, problemin e banimit, kur njerëzit kanë banim e kanë më të lehtë edhe organizimin e familjes dhe normalisht edhe jetën". "Është projekt me vlerë milionëshe. Dëshiroj t'i falënderoj kontribuuesit në këtë projekt, mbi të gjitha qytetarët dhe popullin mik të Katarit, që me paratë e tyre po kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe në adresimin e çështjeve socio-ekonomike në Kosovë", ka thënë Hamza.

Më tutje, kryetari Hamza ka potencuar se, përveç 40 shtëpive, kjo lagje ka edhe objekte përcjellëse, e cila është një prej lagjeve me infrastrukturën më të kompletuar në komunën e Mitrovicës. Ndërkaq drejtori i organizatës "Qatar Charity", Dabab, ka thënë se ndihet i lumtur për realizimin e këtij projekti, i cili për të ka qenë si ëndërr.

## Komuna e Prishtinës themelon Drejtorinë e Sigurisë dhe Emergjencave

PRISHTINË, 2 MARS - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se ka themeluar Drejtorinë e Sigurisë dhe Emergjencave. "Për ta jetësuar përkushtimin tonë për një jetë të sigurt për të gjithë, sot zyrtarisht e themeluam Drejtorinë e Sigurisë dhe Emergjencave në kryeqytet. Sigurinë e qytetarëve të Prishtinës e kemi prioritet", është shprehur Rama.



# Çfarë ka brenda bërthamës së Tokës?



Nga Kenneth CHANG

Bërthama e brendshme e Tokës duket se mban një sekret më të brendshëm. Tekstet e gjeologjisë përfshijnë pothuajse në mënyrë të pashmangshme një diagram të prerë të Tokës që tregon 4 shtresa që përvijohen mjeshtërisht: një guaskë e jashtme e hollë shkëmbinjsh mbi të cilën jetojmë ne, e njohur si kore; manteli, ku shkëmbinjtë lundrojnë si një lëng jashtëzakonisht viskoz, duke nxitur lëvizjen e kontinenteve dhe ngritjen e maleve; një bërthamë e jashtme e lëngshme prej hekuri dhe nikeli që gjeneron fushën magnetike të planetit; dhe një bërthamë e brendshme shumë e fortë.

Duke analizuar kryqëzimin e valëve sizmike nga tërmetet e mëdha, dy shkencëtarë australianë thonë se në qendër të Tokës ekziston një shtresë dukshëm e ndryshme. "Tani e kemi konfirmuar ekzistencën e bërthamës më të brendshme të Tokës"- thotë një nga shkencëtarët, Hrvoje Kalçic, profesor i gjeofizikës në Universitetin Kombëtar Australian në Kanberra.

Dr.Kalçiç dhe Thanh-Son Pham, studiues post-doktoral, vlerësojnë se bërthama më e brendshme e Tokës është rreth 1280 km i gjerë; teksa e gjithë bërthama është rreth 2400 km e gjerë. Gjetjet e tyre u publikuan së fundmi në revistën "Nature Communications".

Ndërsa diagrami i prerë duket se përshkruan disa ndarje të qarta, njohuritë për brendësinë e thellë të Tokës janë pashmangshmërisht të paqarta. Pasi ajo gjendet gati 6400 km në qendër të Tokës, dhe ne e kemi të pamundur të shpojmë më shumë se disa km në koren e Tokës. Shumica e asaj që dihet mbi atë që fshihet poshtë nesh vjen nga valët sizmike, pra nga dridhjet e tërmeteve që udhëtojnë nëpër dhe rreth planetit.

Mendojini ato si një sonogram gjigant i Tokës. Dy sizmologë të Universitetit të Harvardit, Miaki Ishi dhe Adam Dzievonski, propozuan për herë të parë idenë e bërthamës më të brendshme të Tokës në vitin 2002, bazuar në veçoritë e shpejtësisë së valëve sizmike që kalojnë nëpër bërthamën e brendshme.

Shkencëtarët e dinin tashmë se shpejtësia e valëve sizmike që udhëtonin nëpër këtë pjesë të Tokës ndryshonte në varësi të drejtimit. Valët udhëtuan më shpejt kur shkonin nga poli në pol përgjatë boshtit të Tokës dhe më ngadalë kur udhëtonin pingul me boshtin. Gjeofizikantët besojnë se dallimi në shpejtësi – disa për qind më i shpejtë përgjatë shtigjeve polare – buron nga shtrirja e kristaleve të hekurit në bërthamën e brendshme.

Por në një rajon të vogël në qendër, valët më të ngadalta ishin ato që udhëtonin në një kënd 45 gradë me boshtin në vend të 90 gradë, thanë sizmologët e Harvardit. Të dhënat e disponueshme në atë kohë ishin shumë të pakta për t'i bindur që të gjithë. Matjet më të mira do të ishin valët sizmike që udhëtojnë nga origjina e një tërmeti drejt e poshtë në thellësi të Tokë dhe përmes bërthamës më të brendshme të saj.

Sidoqoftë, zbulimi i atyre kërkon në përgjithësi një sizmometër të vendosur pothuajse saktësisht në anën tjetër të Tokës, dhe kjo pikë është në mes të oqeanit. Studimi i ri përfitoi nga fakti se valët sizmike gjithashtu kthehen prapa. Kështu, një sizmometër afër epiqendrës mund të zbulojë reflektimin e valës që udhëtoi nëpër Tokë dhe u kthye prapa, duke kaluar 2 herë përmes bërthamës më të brendshme të brendshme. Ato gjithashtu mund të reflektohen përpara-prapa për herë të dytë, duke udhëtuar 4 herë nëpër bërthamën më të brendshme.

Vitet e fundit, janë vendosur një mori sizmometrash, sidomos në Shtetet e Bashkuara. Kombinimi i sinjaleve nga instrumente të shumta, mundësoi zbulimin e reflektimeve të zbehta që vijnë nga tërmetet me magnitudë 6 të shkallës Riher ose më të madhe. "Ne analizuam 200 ngjarje dhe zbuluam se 16 prej tyre i kishin këto valë kërcyese"- tha dr.Kalçiç.

Në tërmetin që goditi Ishujt Solomon në vitin 2017, valët që udhëtuan 5 herë nëpër bërthamën më të brendshme të Tokës, u zbuluan nga sizmometrat që ishin të pozicionuat rastësisht në anën tjetër të planetit. "Studimet e mëtejshme të këtyre valëve mund të na ndihmojmë të zbërthejmë në një mënyrë më të saktë strukturën e brendshme të bërthamës së Tokës"- thotë Xhorxh Helfrish nga Instituti i Teknologjisë në Tokio, Japoni, që nuk ishte i përfshirë në këtë hulumtim.

Nuk duket se ka ndonjë ndryshim domethënës në përbërje midis pjesëve të jashtme dhe më të brendshme të bërthamës së brendshme të Tokës, dhe tranzicioni duket gradual dhe jo shumë i fortë.

Vernon Kormier, profesor i fizikës në Universitetin e Konektikatit, që nuk ishte i përfshirë në këtë studim, thotë se kjo mund të tregojë një ndryshim në të kaluarën e lashtë të Tokës. Bërthama e brendshme është shumë e re, në aspektin gjeologjik. Sipas Kormier, vlerësimet variojnë nga 600 milionë deri në 1 miliardë vjet. Kjo është vetëm një pjesë e historisë 4.5 miliardë vjeçare të planetit, dhe struktura e bërthamës së fortë duket komplekse. Në janar të këtij viti, disa shkencëtarë të tjerë raportuan se shpejtësia e rrotullimit të bërthamës së brendshme ndryshon.

"Arsyeja pse njerëzit vazhdojnë të studiojnë strukturën e brendshme të bërthamës është se ata përpiqen ta lidhin atë me fushën magnetike të Tokës. Ata përpiqen të identifikojnë një ndryshim në fushën magnetike të Tokës që mund të ketë ndodhur në të njëjtën kohë me ndryshimin në kristalizimin e bërthamës së brendshme"- thekson dr.Kormier.

/ New York Times Bota





# Sport



Veton Zymberi, redaktor i sportit

# 31 bursistë 'Shpresa Olimpike 2023' do të mbështeten nga KOK-u

**Prishtinë, 2 mars** - Komiteti Olimpik i Kosovës do ta vazhdojë mbështetjen për sportistët përmes dhënies së bursave të ndryshme. Bordi ekzekutiv i KOK-ut ka aprovuar listën e komisionit të sportit, për të çuar në 31 nga 25 sosh, numrin e bursistëve "Shpresa Olimpike 2023", të cilët do të përfitojnë bursa mujore nga të hyrat e KOK-ut gjatë vitit 2023. Bursistët iu takojnë 17 sporteve të ndryshme olimpike, ndërsa mbështetja për ta është në vlerë 150 euro në muaj. Në muajin dhjetor 2022 komisioni i sportit kishte bërë një tjetër përzgjedhje, prej 10 bursistëve të cilët do të mbështeten nga Ministria për Kulturë, Rini e Sport.

***Shpresat olimpike 2023:***

*Fatjona Kasapi (xhudo), Muharrem Hyseni (xhudo), Rios Kuka (xhudo), Suela Canolli (boks), Loris Idrizi (boks), Sara Susuri (atletikë), Granit Ahmeti (atletikë), Olti Bytyqi (atletikë), Omer Azemi (çiklizëm), Valëza Rama (gjimnastikë), Vilëza Zeqiri (gjimnastikë), Fleta Deçani (kajakim), Fatih Karabaxhaku (pingpong), Shega Hashani (pingpong), Ndriçim Raçi (shenjëtari sportive), Genc Isufi (triatlon), Drin Kokaj (skitari), Lirika Deva (skitari), Klos Vokshi (skitari), Egzon Xhoni (mundje), Valmir Gllareva (shigjetari), Denis Bllaca (taekwondo), Mal Sahiti (taekwondo), Mal Gashi (not), Vesa Gjinaj (tenis), Aja Broqi (tenis), Megi Bislimi (volejboll), Etna Rexhepi (basketboll), Merisa Bilalli (basketboll), Olsa Tahiri (basketboll), Yllza Uka (basketboll).*




# Gjimshiti: Gasperini ndryshoi gjithçka, tani jam kthyer në formë

**Bergamo, 2 mars** - Berat Gjimshiti ka qenë një nga futbollistët më të rëndësishëm të Atalantës në vitet e fundit. Mbrojtësi shqiptar është pjesë e skuadrës zikaltër që nga janari i vitit 2016 dhe kaloi dy sezone si i huazuar, njëherë tek Avellino dhe një herë tjetër te Benevento. Por këtë edicion Gjimshiti nuk po luan shumë pasi në fillim pati një lëndim të rëndë që e mbajti jashtë fushave për rreth dy muaj dhe pastaj humbi vendin e titullarit deri para një muaji kur e riktheu atë. Në një intervistë për gazetën italiane "Tuttosport", Gjimshiti ka folur rreth karrierës së tij tek Atalanta, teksa për gjithë sukseset thotë se është meritor trajneri Gian Piero Gasperini. "Statistikat personale të këtij sezoni me Atalantën janë shumë të rëndësishme për mua. Kur unë u transferova tek Atalanta në krye të skuadrës ishte ende Edy Reja si trajner dhe vetëm më pas erdhi Gasperini me të cilin nisëm një cikël fantastik. U kualifikuam në Ligën e Evropës, pastaj në Ligën e Kampionëve. Në fillim



të aventurës me Atalantën më larguan në huazim për dy sezone, por më pas u riktheva dhe gjithçka ndryshoi", ka deklaruar Gjimshiti.

Mbrojtësi nga Lugina e Preshevës foli edhe për sezonin aktual, duke thënë se, pavarësisht prej disa ndeshjeve jo të mira, do të rikthehen. "Ky sezon është shumë i balancuar. Të gjitha ndeshjet janë të vështira dhe kampionati si rrjedhojë bëhet i komplikuar. Unë besoj shumë te projekti i Atalantës, por edhe te shokët e skuadrës. Kemi kaluar edhe kohë më të vështira, por gjithnjë kemi ditur të rikthehemi. E kemi treguar forcën", ka shtuar Gjimshiti.

Krejt në fund ai foli edhe për lëndimin e pësuar dhe humbjen e vendit të titullarit, duke thënë se rëndësi ka vetëm skuadra të përforcojë mirë. "Në dy ndeshjet e para të sezonit unë isha titullar, por më pas erdhi dëmtimi. Pata një problem në sfidën me Milanin pas një dueli me Origin. Më pas kur u riktheva nga dëmtimi ishin të tjerë lojtarë që po bënin mirë në atë moment dhe nuk mund të rikthehesha menjëherë si titullar. Por, nuk asnjë problem në këtë pikë sepse bëhet për të mirën e skuadrës", u shpreh Gjimshiti.

# Shkëlqen Aulona, shpallet MVP



**Prishtinë, 2 mars** - Në javën e nëntë të Ligës Unike të femrave u zhvilluan disa përballje mjaft interesante, duke përmendur ndeshjen Tirana - Penza që shkoi në dy vazhdime. Bashkimi të mërkurën mbrëma në Tiranë mundi Partizanin, ku shkëlqeu Aulona Muhadri. Basketbollistja prizrenase kishte 25 pikë, 14 kërcime dhe tri asistime. Qendra e Kosovës kishte indeksin 38, apo më të lartin e kësaj xhiroje, duke u shpallur MVP. Ajo u ndihmua nga Dasia Evans me 21 pikë, 13 kërcime dhe një asistim. Prishtina mundi liderin Flamurtarin, duke siguruar një vend në Final 4. Te skuadra prishtinase më të mirat ishin Adrienne Godbold me 25 pikë, tetë kërcime dhe 4 asistime, si dhe Sarah Mgbeike (Prishtina) 28 pikë, shtatë kërcime dhe dy asistime. Tirana pas dy vazhdimeve mundi Penzën, ku më e mira ishte basketbollistja bardheblu Klea Verri me 20 pikë, dhjetë kërcime dhe tetë asistime.

## Turneu 'Adem Jashari' mbahet në Skenderaj

**Prishtinë, 2 mars** - Në kuadër të shënimit të Epopesë së UÇK-së, Federata e Futbollit e Kosovës nëpërmjet Komisionit për Futsall do ta organizojë turneun tradicional "Adem Jashari". Ky është edicioni i 14-t me radhë dhe meqenëse Përfaqësuesja e Kosovës është e angazhuar në ndeshjen kualifikuese për Botëror, edicioni i sivjetmë do të mbahet me pjesëmarrjen e katër ekipeve të Superligës: FC Prishtina 01, FC Liqeni, FC Malisheva dhe FC Drenica. Turneu fillon më 5 mars, me ndeshjet gjysmëfinale ndërmjet FC Drenicës dhe FC Malishevës, në orën 18:00 dhe FC Prishtina 01 dhe FC Liqenit, në orën 20:00. Ndërkaq, ndeshja finale zhvillohet të hënën më 6 mars në orën 19:30. Turneu do të zhvillohet në palestrën "Ilaz Kodra" në Skenderaj.



## Mbappe e mbështet popullin turk: Do ta bëj maksimumin që t'i ndihmoj të ringrihet

Paris, 2 mars - Kylian Mbappe e ka shprehur solidaritetin e tij përkrah popullit turk, të goditur nga tërmeti i tmerrshëm i muajit të kaluar, i cili i la më shumë se 40 mijë persona të vdekur. Ylli francez ishte i ftuar në kanalin turk "TRT Sport", përmes të cilit e shprehu gatishmërinë e tij për t'i ndihmuar të prekurit e tërmetit shkatërrimtar. "Ishte një ngjarje mjaft tragjike. As që mund ta imagjinoja dhimbjen që e ka përjetuar populli turk. Futbolli botëror e mbështet Turqinë dhe do të bëjë gjithçka që është e mundshme ta ndihmojë këtë vend për t'u rindërtuar. Është një nder i madh për mua të bëj pjesë në këtë kauzë. Do ta bëj më të mirën për të ndihmuar", ka deklaruar futbollisti i Paris Saint-Germainit. "Do ta jap maksimumin nga vetja për të bërë mirë, brenda dhe jashtë fushës. Sot Turqia gjendet në një situatë të vështirë dhe shpresoj se do të dalim që ta kalojmë këtë gjendje. Për t'u rikthyer për të luajtur në Turqi dhe për t'i takuar fëmijët, për t'i bërë ata që të buzëqeshin", ka deklaruar përfaqësuesi francez.



## Fazliu: Nëse vazhdojmë kështu, mbijetesa nuk është problem

Ferizaj, 2 mars - Me të përfunduar stinori vjeshtor në Albi Mall Superligën e Kosovës në futboll, të gjithë ishin të bindur se Ferizaj tashmë është skuadër që nuk mund të mbijetojë. Madje kishte zëra se Ferizaj edhe do ta prishë garën pasi në pranverë do të jetë ekip i dorëzuar, raporton "Demokracia.com". Megjithatë në katër javët e para po ndodh diçka krejt tjetër, dy fitore dhe dy barazime bën që Ferizaj t'i shmanget vendit të fundit në tabelë dhe tash është i parafundit me 21 pikë të tubuar. Ferizaj është shndërruar në një ekip tejet të fortë dhe këtë më se miri mund ta dëshmojnë Prishtina e Drita që i mposhti duke u marrë pikë të plota. Sulmuesi me përvojë Astrit Fazliu ka treguar atmosferën që po mbretëron në ekip dhe pritshmëritë e tyre në pranverë. "Realisht kemi bërë diçka që askush nuk e ka pritur. Një fillim mbresëlënës, por jemi të vetëdijshëm se nuk ka përfunduar asgjë dhe ka ende shumë punë për t'u bërë deri në fund", ka thënë Fazliu.



Gjithsesi, pa një atmosferë të mirë këto rezultate as nuk do të mendoheshin, por atmosferën e mirë e krijojnë financat stabile. Ferizaj tash për tash njihet si një ndër skuadrat më korrekte sa iu përket pagave, dhe se lojtarët të gjithë fokusin e kanë vetëm te puna. "Atmosfera është shumë e mirë. Po mundohemi secili ta japim atomin e fundit që ta arrijmë objektivin tonë, mbetjen në Superligë. Nëse arrijmë ta mbajmë këtë ritëm, them se nuk do të jetë problem mbetja në Superligë", ka përfunduar Fazliu. Ndeshjen e radhës Ferizaj e luan si mysafir në Skenderaj ndaj Drenicës, rival ky për mbijetesë dhe nëse aty merr pikë, atëherë Ferizaj do të bëjë një hap të madh drejt mbijetesës.

## Milwaukee vijon marshimin, Duranti debuton me fitore te Phoenixi

Milwaukee, 2 mars - Nuk ndalet ekipi i Milwaukee Bucksit, që mposhti me rezultat 139-117 Orlandon dhe korri fitoren e 16 radhazi. Të gjithë titullarët e Bucksit realizuan mbi 10 pikë, me Giannis që bëri dallimin, autor i 31 pikëve. Rikthehet te fitorja skuadra e lakersave, që mundi me rezultat 123-117 Oklahoman në fushën e kësaj të fundit. Dennis Schroder me 26 pikë ishte më i miri për lakersat në këtë ndeshje. Fiton edhe ekipi i Phoenixit, që mposhti me rezultat 105-91 Charlotten jashtë fushës, sfidë ku Kevin Durant bëri debutimin e tij me Suns. Ai realizoi 23 pikë, ndërkohë që shënuesi më i mirë për Phoenixin ishte Devin Bookeri me 37 pikë. Skuadra e Philadelphias, falë 27 pikëve të Maxey dhe 23 të Hardenit, mposhti me rezultat 119-96 Miamin, një përballje mes dy ekipesh rivale në Konferencën e Lindjes. Edhe Bostoni rikthehet te fitorja në kampionat, duke mundur me rezultat 117-113 Clevelandin, në një ndeshje me rivalitet deri në fund. Mitchelli realizoi 44 pikë për cavaliersat, por që s'mjaftuan, ndërsa për Celticsin u dallua Jayson Tatum me 41 pikë e 11 rebounde. Chicago mposhti në fund Detroitin me shifrat me rezultat 117-115, ndeshje ku dallimin e bëri Zach LaVine, autor i 41 pikëve për Bullsin.



**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Charlotte - Phoenix | 91-105 |
| Detroit - Chicago | 115-117 |
| Boston - Cleveland | 117-113 |
| Miami - Philadelphia | 96-119 |
| New York - Brooklyn | 142-118 |
| Houston - Memphis | 99-113 |
| Milwaukee - Orlando | 139-117 |
| Oklahoma - Lakers | 117-123 |
| Portland - New Orleans | 110-12 |

## SHKURT

### Sane rrezikon ta humbasë ndeshjen ndaj PSG-së

Mesfushori gjerman i Bayern Munchenit, Leroy Sane, rrezikon ta humbasë ndeshjen e kthimit të Ligës së Kampionëve ndaj PSG-së. Sipas së përditshmes gjermane "Bild", mesfushori nuk është stërvitur dy seancat e fundit për shkak të një ndrydhjeje në kavilje. Problemi është disi më i madh sesa parashikohej, ndaj mund të qëndrojë disa javë pushim. Lojtari u është nënshtruar analizave të mëtejshme, duke mos zbritur në stërvitje me pjesën tjetër të ekipit. Sane nuk do të zbresë në fushë ditën e shtunë ndaj Stuttgartit në kampionat, me shpresën që të rikuperojë për sfidën e Ligës së Kampionëve. Gjendja e tij do të monitorohet ditë pas dite.

### Ronaldo i pasur, por jo në krye të listës

Cristiano Ronaldo është sportisti më i paguar në botë. Futbollisti portugez fiton 200 milionë dollarë në vit (rreth 188 milionë euro) falë kontratës së tij trevjeçare të nënshkruar së fundmi me Al-Nassr të Ligës së Arabisë Saudite. Megjithatë, nuk është ai që gjeneron më shumë para në lidhje me angazhimin kohor që i kushton disiplinës së tij sportive. Duke i ndarë të ardhurat e Ronaldos për minutë, portugezi fiton rreth 3 760 euro çdo 60 sekonda, një shifër kjo e tejkaluar kryesisht nga fituesi i Kupës Saudite, gara e kuajve që shpërndan më shumë para në mbarë botën. Të shtunën e kaluar u zhvillua edicioni i katërt i Kupës së Arabisë Saudite, ku fitoi kali japonez Phantalassa i drejtuar nga Lord Kanaloa. Kalorësi dominoi garën nga fillimi në fund dhe iu dha një çek prej 9.5 milionë eurosh. Gara me kuaj zgjati vetëm dy minuta, që do të thotë se fituesi gjeneroi 4.686.250 euro në minutë. Një shifër thjesht e paarritshme për çdo sport tjetër për sa iu përket parave të marra në raport me kohën që zgjat gara.

### Zidane në listën e Chelseat për pasardhës të Potterit

Ish-trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, është në listën e Chelseat, gjithmonë nëse shkarkohet trajneri aktual Graham Potter. Në listën e Chelseat është edhe ish-trajneri i Barcelonës dhe Spanjës, Luis Enrique. Potter është nën presion serioz në "Stamford Bridge" mes një ecurie katastrofale të formës që ka parë që "blutë" të marrin vetëm një fitore në 11 ndeshje, pasi shpenzuan afër 300 milionë funte për nënshkrime të reja në janar. Ndërsa ai ka marrë mbështetje të pakushtëzuar nga pronari Todd Boehly deri në këtë pikë, besohet se dy ndeshjet e tyre të ardhshme kundër Leeds Unitedit dhe Borussia Dortmundit mund të jenë vendimtare për ish-trajnerin e Brightonit, i cili ka fituar vetëm nëntë nga 26 ndeshjet e tij në krye.

## Barça nënshkruan me djalin e Ronaldinhos

